

# Armët e zjarrit dhe demenca

FLETË INFORMACIONI NGA QENDRA SUEDEZE E DEMENCËS

Vapen och demenssjukdom • faktablad på albanska

## Simptomat pengojnë vendimmarrjen

Demenca e bën më të vështirë të menduarit, planifikimin, komunikimin dhe të menduarit siç duhet për vendimet. Simptomat shkaktohen nga sëmundje të ndryshme dhe dëmtime në tru.

Kujtesa zakonisht përkeqësohet e para dhe orientimi bëhet më i vështirë. Gjuha dhe funksionet e tjera mendore preken gjithashtu.

Simptomat e demencës bëhen veçanërisht të dukshme në situata kur është e nevojshme të përpunohen sasi të mëdha informacioni dhe të merren vendime të shpejta. Përdorimi i armës së zjarrit është shembull i një situate të tillë.

## Rreziqet që lidhen me armët e zjarrit për njerëzit me demencë

Aftësia teknike për të përdorur një armë zjarri, nuk humbet menjëherë si pasojë e demencës. Problemi është se sëmundja shkakton ndryshime në tru që mund të ndikojnë në aftësinë për të vepruar, për t'u përqendruar dhe për të marrë vendime të arsyeshme, madje edhe në fazë të hershme. Individët me demencë që përdorin armë zjarri, mund të rrezikojnë si veten, ashtu edhe të tjerët.

Demenca gjithashtu e bën më të vështirë ndjekjen e rregulloreve për ruajtjen e armëve të zjarrit. Prandaj ekziston rreziku që arma e zjarrit të përfundojë në duar të gabuara.

## Konsultohuni me mjekun

Nëse dyshoni për demencë, drejtohuni te mjeku sa më shpejt që të jetë e mundur. Është e rëndësishme të kryhet një hetim pa humbur kohë, për të marrë diagnozën, ndihmën dhe trajtimin e duhur. Nëse diagnostikohet demenca, mjeku duhet të informohet nëse pacienti zotëron armë zjarri.

## Vlerësimi i pengesave mjekësore

Demenca është një nga gjendjet shëndetësore që mund të përbëjë pengesë ligjore-mjekësore për mbajtjen e vazhdueshme të armëve të zjarrit. Sipas Ligjit për Armët, është përgjegjësi e mjekut të vlerësojë nëse

një pacient i plotëson kushtet nga ana mjekësore për të zotëruar armë zjarri. Nëse është kështu, pacienti duhet të informohet. Mjeku është gjithashtu i detyruar ta raportojë këtë në polici. Vendimi për vazhdimin e pronësisë së armës së zjarrit dhe licencës së armës merret më pas nga policia.

Policia mund të japë gjithashtu këshilla dhe të ndihmojë me çështjet praktike që dalin pas revokimit të licencës së armës.



## Një çështje e ndjeshme

Moslejimi i mëtejshëm për të zotëruar armë zjarri, mund të jetë një çështje e ndjeshme, e lidhur me identitetin dhe vetëvlerësimin. Për shumë njerëz, gjuetia e drerëve në vjeshtë është një nga ngjarjet kulmore të vitit. Kjo ngjarje përfaqëson emocionin, komunitetin dhe traditën.

Prandaj, është mirë që të afërmit të informohen në fazat e hershme për rregulloret në lidhje me zotërimin e armëve të zjarrit dhe demencën. Është e mundur që individi të marrë përsipër një rol të ri brenda ekipit të gjuetisë.

## Më shumë informacion

*Raportimi i pacientëve që i plotësojnë kushtet nga ana mjekësore për të zotëruar armë zjarri*, Bordit Kombëtar Suedez të Shëndetit dhe Mirëqenies

(*Anmälan av patienter som av medicinska skäl är olämpliga att inneha skjutvapen*, Socialstyrelsen) 2008:21 • [www.socialstyrelsen.se](http://www.socialstyrelsen.se)

*Ligji për Armët*, Kodi i Ligjeve Suedeze (*Vapenlag*, Svensk författningssamling) 1996:97

© Svenskt Demenscentrum

Informacion shtesë dhe materiale informuese në gjuhën shqipe, mund të gjenden në faqen zyrtare të Svenskt Demenscentrum: [www.demenscentrum.se/al](http://www.demenscentrum.se/al)



Svenskt Demenscentrum

Svenskt Demenscentrum, Sveavägen 155, 113 46 Stockholm, (08) 690 58 00, [info@demenscentrum.se](mailto:info@demenscentrum.se)

[www.demenscentrum.se](http://www.demenscentrum.se)

# Vapen och demenssjukdom

FAKTABLAD FRÅN SVENSKT DEMENSCENTRUM

## Symtom försvårar genomtänkta beslut

Demenssjukdom gör det svårare att tänka, planera och kommunicera. Symtomen orsakas av olika sjukdomar och skador i hjärnan.

Vanligen försämras först minnet och det blir svårare att orientera sig. Även språket och andra så kallade *kognitiva funktioner* drabbas.

Demenssymtomen blir särskilt märkbara i situationer då man ska bearbeta stora mängder information och snabbt fatta beslut. Hantera skjutvapen kan vara ett exempel på en sådan situation.

## Risker med vapen vid demens

Förmågan att rent tekniskt hantera vapen försvinner inte automatiskt med demenssjukdomen. Problemet är att sjukdomen orsakar förändringar i hjärnan som redan tidigt kan påverka handlingsförmåga, koncentration och omdöme. Med skjutvapen i hand kan personer med demenssjukdom riskera att skada både sig själv och andra.

Demenssjukdom gör det även svårare att följa bestämmelserna för hur vapen ska förvaras. Vapnet riskerar därför att hamna i orätta händer.

## Rådgör med en läkare

Vid misstanke om demens bör en läkare snarast kontaktas. Det är viktigt att i god tid påbörja en utredning för att få rätt diagnos, hjälp och behandling. Om en demenssjukdom konstateras och personen i fråga äger skjutvapen ska läkaren informeras om detta.

## När det finns medicinska hinder

Demens är ett av de sjukdomstillstånd som kan utgöra ett medicinskt hinder för fortsatt vapeninnehav. Enligt vapenlagen är det läkaren ansvar att bedöma om en patient av medicinska skäl är olämplig att inneha skjutvapen. Om så är fallet ska patienten informeras om detta. Läkaren är

också skyldig att göra en anmälan till polismyndigheten som sedan fattar beslut om fortsatt innehav av skjutvapen och vapenlicens.

Polismyndighetens handläggare kan även ge råd och hjälpa till med de praktiska frågor som följer av en indragen vapenlicens.



## En känslig fråga

Att inte längre få inneha vapen kan vara en känslig fråga om identitet och självkänsla. För många är en av årets höjdpunkter höstens älgjakt som står för spänning, gemenskap och tradition.

Därför är det bra om anhöriga redan tidigt informeras om bestämmelserna kring vapeninnehav och demenssjukdom. Kanske kan personen få en ny funktion i jaktlaget.

## Mer information

*Anmälan av patienter som av medicinska skäl är olämpliga att inneha skjutvapen*, Socialstyrelsen föreskrift 2008:21 • [www.socialstyrelsen.se](http://www.socialstyrelsen.se)

*Vapenlag*, Svensk författningssamling (1996:97)

2025 • Svenskt Demenscentrum ©

---

Fler faktablad på olika språk kan skrivas ut från Svenskt Demenscentrums webbplats:  
[www.demenscentrum.se/Faktablad](http://www.demenscentrum.se/Faktablad)

---



Svenskt Demenscentrum

Svenskt Demenscentrum, Sveavägen 155, 113 46 Stockholm, 08 - 690 58 00, [info@demenscentrum.se](mailto:info@demenscentrum.se)

[www.demenscentrum.se](http://www.demenscentrum.se)